



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 09

Datë: 21. 02. 2024.

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Raportet e Këshillave të KQZ-së:

2.2.Këshilli për Buxhet dhe Financa

- Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit dhe korigjimit të Raportit vjetor financiar të KQZ për vitin 2023

3. Të ndryshme

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Në këtë mbledhje të mbajtur “on linë”, pas njoftimit me agjendën e takimit, është miratuar rendi i ditës dhe pastaj, është shqyrtuar një pikë e rendit që ka pas të bëj me plotësimin dhe korigjimin e Raportit vjetor financiar të KQZ për vitin 2023.

2.Raportet e Këshillave të KQZ-së:

2.2.Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit dhe korigjimit të Raportit vjetor financiar të KQZ për vitin 2023:

Këshilli për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin Vjetor Financiar të vitit 2023. Pasqyrat financiare të bashkangjitura në raport, kanë përfshirë të dhënat e shpenzimeve të përgatitura nga DAP. Në raport, është vënë në dukje nga Sekretariati, DAP-i dhe Zyra e Thesarit të vendit se, ky raport financiar (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në Shënimet Financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Këshilli, ka vlerësuar se raporti është i hartuar me përkushtim, dhe se ka pasqyruar në mënyrë korrekte, dhe me përgjegjësi analizën dhe pasqyrimin financiar për vitin kalendarik të shpenzimeve të vitit 2023. Andaj, ka rekomanduar për miratim nga anëtarët e KQZ.

Raportin, e kanë votuar: Kreshnik Radoniqi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Grodana Llaban, Fazli Stollaj, Mufera Shinik dhe Qemailj Kurtisi.

3.Të ndryshme !

P.s

Kjo mbledhje është mbajtur "On – line".